



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 002/13

Datë: 10.05. 2022

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, (LVL) Nr. 03/L-040, neni 12, paragrafi 12.2, Statutit të Komunës së Junikut (të datës 29.9.2010), neni 21, paragrafi 21.1 pika j) Kuvendi Komunal në Junik në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 29.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

për plotësim ndryshimin e Rregullores për Tatimit mbi Pronën e Paluajtshme për vitin 2023

- I. Me këtë vendim fillohet plotësim ndryshimi i Rregullores për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme për vitin 2023/ në tekstin e mëtejme projekt rregullorja.
- II. Qëllimi i nxjerrjes dhe miratimit të kësaj (projekt) Rregulloreje, sipas këtij vendimi është krijimi i bazës ligjore për fillimin e plotësimit dhe ndryshimit të Rregullores për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme për vitin 2023.
- III. Bartëse e (projekt) Rregullores nga pika I e këtij Vendimi është Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
- IV. Bartësja e hartimit të (projekt) Rregullores është e obliguar që (projekt) Rregulloren ta hartoj në afat prej 6 muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
- V. Autorizohet Kryetari i Komunës së Junikut që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi ta emëroj grupin punues për hartimin e (projekt) Rregullores nga pika I e këtij Vendimi.
- VI. (projekt) Rregullorja duhet të vihet në shqyrtim publik. Paraqitja e (projekt) Rregullores në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen në ueb faqen e Komunës së Junikut.
- VII. Pas hartimit (projekt) Rregullorja i procedohet kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim.
- VIII. Mjetet financiare për hartimin e (projekt) Rregullores sigurohen nga buxheti i Komunës së Junikut.
- IX. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anë të të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

- X. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës respektivisht Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
- XI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhen zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut

Me këtë vendim njoftohen:

- MPL,
- Kryetari i komunës së Junikut
- Ministria e Financave,
- Shërbimi i Kuvendit,
- Arkiva.

